



Datë: 19.05.2025
Numër Protokolli: 3262/2025

A.nr.439/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari–anëtarë, me Çlirim Zeka-në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.439/2025 të datës 10.03.2025 të parashtruar nga ankuesit K.J, F.L, S.F, F.G, Z.D, E.L, G.B, N.G, Sh.R, S.D, N.V, V.U, H.N, J.M, L.K, F.XH, Sh.R, B.V, F.A, H.K, K.H, H.Z, N.D, A.R, B.B, B.Z, D.SH, S.H, Z.S, I.S, S.F, S.H, F.O, P.S, H.M, D.A, A.G, N.L, L.U, H.R, Z.S, N.Z, A.B, H.H, I.A, R.M, H.K, L.F, Xh.M, N.G, S.D, A.D, B.K, F.L-M, Sh.H, N.L, V.S, E.S, R.SH, F.S, V.H, A.A, M.L, S.A, A.A, V.A, A.I, V.J, A.M, Z.R, Z.E, B.H, B.K, Sh.F, R.V, Y.V, M.V, D.B, N.L,B.I, A.G, F.R, A.M, R.H, G.P, B.S, Xh.D, V.H, H.G, H.G, Sh.Q, Q.D- U, F.F, Z.P, D.K, R.Y, Rr.I, F.B dhe I.P të cilët me autorizim i përfaqëson avokati Esat Sylja nga Skenderaji kundër organit të punësimit Komunës së Skenderajit, në çështjen juridike “*Kompensim Material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 dhe 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 19.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.439/2025 të datës 10.03.2025 për ankuesit F.G, E.L, S.H, Z.S, H.M, A.G, H.H, Xh.M, F.R, F.F dhe Rr.I.

I. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit të Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik të Komunës së Skenderajit.

I. Detyrohet Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Skenderajit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës së ankuesve me numër 02-120/01-0003884/25 të datës 23.01.2025 që ndërlidhet me kërkesën e ankuesve.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Grupi i ankuesve të përcaktuar në preambulë të këtij vendimi, *(tutje referuar vetëm grup ankuesish)*, me datë 10.03.2025 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 1534/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për shujtat për ditët e pranisë në punë nga viti 2021 deri me datë 06.02.2023 nga katër (4) Euro për një ditë pune duke u bazuar në vendimin e Qeverisë Nr.08/48 të datës 09.09.2015, shtesat në pagë për secilin nëpunës të Komunës prej 0.5% për vitet e përvojës në punë nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik nga data 06.02.2023 e tutje lidhur me nxjerrjen e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetueses KO79/23 i datës 23.01.2024, shtesat e SHCK në pagë nga 31.20 euro për muaj për secilin nëpunës nga data 06.02.2023 e tutje ashtu siç i kanë realizuar para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik kërkojnë ti aprovohet kërkesa e tyre dhe të obligohet Komuna e Skenderajit tua njohë këto të drejta.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.03.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Skenderajit, ndërsa Këshilli më datë 07.04.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Skenderajit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë vendimin me numër VK/2025 me datë 22.04.2025 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesve edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1534/2024 të datës 10.03.2025 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigje në kërkesë i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Skenderajt me nr.02-120/01-0005626/25 i datës 05.02.2025; Përgjigje në kërkesë i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Skenderajt me nr.02-120/02-0005627/25 i datës 05.02.2025; Vendim për rishikimin e ndarjes së shtesave të cilat realizohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës me nr.08/48 i datës 09.09.2025; Autorizim nga K.J. për E.A. i datës 20.09.2024; Autorizim nga E.L. për E.A. i datës 20.09.2024; Autorizim nga H.N. për E.A. i datës 10.09.2024; Autorizim nga J.M. për E.A. i datës 11.09.2024; Autorizim nga L.K. për E.A. i datës 11.09.2024; Autorizim nga F.Xh. për E.A. i datës 11.09.2024; Autorizim nga Sh.R. për E.A. i datës 10.09.2024; Autorizim nga B.V. për E.A. i datës 10.09.2024; Autorizim nga F.A. për E.A. i datës 23.09.2024; Autorizim nga H.K. për E.A. i datës 29.08.2024; Autorizim nga K.H.S. për E.A. i datës 26.08.2024; Autorizim nga H.Z. për E.A. i datës 26.08.2024; Autorizim nga F.L.M. për E.A. i datës 13.09.2024; Autorizim nga S.F. për E.A. i datës 18.09.2024; Autorizim nga F.G. për E.A. i datës 20.09.2024; Autorizim nga Z.D. për E.A. i datës 18.09.2024; Autorizim nga G.B. për E.A. i datës 28.08.2024; Autorizim nga N.G. për E.A. i datës

18.09.2024; Autorizim nga Sh.R. për E.A. i datës 11.09.2024; Autorizim nga S.D. për E.A. i datës 20.09.2024; Autorizim nga N.V. për E.A. i datës 11.09.2024; Autorizim nga V.U. për E.A. i datës 11.09.2024; Autorizim nga N.D. për E.A. i datës 22.08.2024; Autorizim nga A.R. për E.A. i datës 22.08.2024; Autorizim nga B.B. për E.A. i datës 22.08.2024; Autorizim nga B.Z. për E.A. i datës 22.08.2024; Autorizim nga D.Sh. për E.A. i datës 20.09.2024; Autorizim nga S.H. për E.A. i datës 20.09.2024; Autorizim nga Z.S. për E.A. i datës 20.09.2024; Autorizim nga I.S. për E.A. i datës 18.09.2024; Autorizim nga S.F. për E.A. i datës 18.09.2024; Autorizim nga S.H. për E.A. i datës 18.09.2024; Autorizim nga F.O. për E.A. i datës 18.09.2024; Autorizim nga P.S. për E.A. i datës 13.09.2024; Autorizim nga H.M. për E.A. i datës 11.10.2024; Autorizim nga D.A. për E.A. i datës 13.09.2024; Autorizim nga A.G. për E.A. pa datë; Autorizim nga N.L. për E.A. i datës 17.09.2024; Autorizim nga L.U. për E.A. i datës 17.09.2024; Autorizim nga H.R. për E.A. i datës 11.09.2024; Autorizim nga Z.S. për E.A. i datës 11.09.2024; Autorizim nga N.Z. për E.A. i datës 18.09.2024; Autorizim nga A.B. për E.A. i datës 11.09.2024; Autorizim nga H.H. për E.A. i datës 11.09.2024; Autorizim nga I.A. për E.A. i datës 11.09.2024; Autorizim nga R.M. për E.A. i datës 11.09.2024; Autorizim nga H.K. për E.A. i datës 11.09.2024; Autorizim nga L.F. për E.A. i datës 11.09.2024; Autorizim nga Xh.M. për E.A. i datës 11.09.2024; Autorizim nga N.G. për E.A. i datës 12.09.2024; Autorizim nga S.D. për E.A. i datës 10.09.2024; Autorizim nga A.D. për E.A. i datës 12.09.2024; Autorizim nga F.R. për E.A. i datës 24.09.2024; Autorizim nga A.G. për E.A. i datës 02.01.2024; Autorizim nga A.L. për E.A. i datës 03.12.2024; Autorizim nga J.O. për E.A. i datës 03.12.2024; Autorizim nga Sh.G. për E.A. i datës 23.01.2025; Autorizim nga B.G. për E.A. i datës 19.12.2024; Autorizim nga R.Sh. për E.A. i datës 19.12.2024; Autorizim nga M.G. për E.A. i datës 20.12.2024; Autorizim nga V.H. për E.A. i datës 24.09.2024; Autorizim nga Xh.D. për E.A. i datës 23.09.2024; Autorizim nga B.I. për E.A. i datës 03.10.2024; Autorizim nga D.B. për E.A. i datës 20.09.2024; Autorizim nga M.V. për E.A. i datës 20.09.2024; Autorizim nga Y.V. për E.A. i datës 23.09.2024; Autorizim nga R.V. për E.A. i datës 20.09.2024; Autorizim nga Sh.F.H. për E.A. i datës 30.09.2024; Autorizim nga B.K. për E.A. i datës 20.09.2024; Autorizim nga B.H. për E.A. i datës 23.09.2024; Autorizim nga Z.E. për E.A. i datës 04.10.2024; Autorizim nga Z.R. për E.A. i datës 22.08.2024; Autorizim nga A.M. për E.A. i datës 22.08.2024; Autorizim nga V.J. për E.A. i datës 22.08.2024; Autorizim nga A.I. për E.A. i datës 22.08.2024; Autorizim nga V.A.O. për E.A. i datës 22.08.2024; Autorizim nga A.A. për E.A. i datës 22.08.2024; Autorizim nga S.A. për E.A. i datës 22.08.2024; Autorizim nga M.L. për E.A. i datës 22.08.2024; Autorizim nga A.A. për E.A. i datës 22.08.2024; Autorizim nga V.H. për E.A. i datës 22.08.2024; Autorizim nga F.S. për E.A. i datës 23.08.2024; Autorizim nga R.Sh. për E.A. i datës 23.08.2024; Autorizim nga E.S. për E.A. i datës 22.08.2024; Autorizim nga V.S. për E.A. i datës 23.08.2024; Autorizim nga N.L. për E.A. i datës 23.08.2024; Autorizim nga Sh.H. për E.A. i datës 23.08.2024; Autorizim nga F.L.M. për E.A. i datës 23.08.2024; Autorizim nga B.K. për E.A. i datës 23.08.2024; Autorizim nga I.P. për E.A. i datës 05.11.2024; Autorizim nga F.B. për E.A. i datës 05.11.2024; Autorizim nga Rr.I. për E.A. i datës 07.11.2024; Autorizim nga R.Y. për E.A. i datës 09.10.2024; Autorizim nga D.K. për E.A. i datës 07.10.2024; Autorizim nga Z.P. për E.A. i datës 04.10.2024; Autorizim nga F.F. për E.A. i datës 09.10.2024; Autorizim nga Q.D.U. për E.A. i datës 09.10.2024; Autorizim nga SH.Q. për E.A. i datës 09.10.2024; Autorizim nga H.G. për E.A. i datës 09.10.2024; Autorizim nga H.G. për E.A. i datës 10.10.2024; Autorizim nga Sh.G. për E.A. i datës 14.03.2025; Autorizim nga B.S. për E.A. i datës 24.09.2024; Autorizim nga G.P. për E.A. i datës 24.09.2024; Autorizim nga R.H. për E.A. i datës 24.09.2024; Autorizim nga A.M. për

E.A. i datës 24.09.2024; Autorizim nga B.L.K. për E.A. i datës 09.10.2024; Autorizim nga M.K. për E.A. i datës 09.10.2024; Pliko me numër R6562994 i datës 06.03.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 25.03.2025; Përgjigje në ankesë i datës 07.04.2025; Kërkesë me nr. protokoli 02-120/01-0003884/25 e datës 23.01.2025; Kërkesë me nr. protokoli 02-120/01-0003879/25 e datës 23.01.2025; Kontratë e Marrëdhënies së Punës e K.J. i datës 06.02.2023; Vendim për emërim të punëtorit i S.F. i datës 01.06.2011; Akt Emërim i F.L.M. i datës 11.06.2019; Akt Emërim i F.G. i datës 25.04.2012; Akt Emërim i Z.D. i datës 03.04.2012; Kontratë e Marrëdhënies së Punës e E.L. i datës 06.02.2023; Akt Emërim i G.B. i datës 04.03.2021; Akt Emërim i N.G. i datës 03.07.2018; Akt Emërim i Sh.R. i datës 03.05.2012; Vendim për transfer i S.D. i datës 24.12.2024; Akt Emërim i N.V. i datës 11.06.2019; Akt Emërim i V.U. i datës 25.04.2012; Akt Emërim i H.N. i datës 28.12.2016; Akt Emërim i J.M. i datës 18.05.2021; Akt Emërim i L.K. i datës 11.03.2022; Akt Emërim i F.Xh. i datës 19.10.2012; Ndryshim dhe plotësim i akt emërimit i Sh.R. i datës 24.01.2020; Akt Emërim i B.V. i datës 01.11.2013; Akt Emërim i F.A. i datës 03.05.2012; Akt Emërim i H.K. i datës 27.04.2012; Akt Emërim i K.H.S. i datës 25.02.2020; Akt Emërim i H.Z. i datës 27.04.2012; Akt Emërim i N.D. i datës 25.04.2012; Akt Emërim i A.R. i datës 23.03.2021; Akt Emërim i B.B. i datës 01.10.2020; Akt Emërim i B.Z. i datës 11.06.2020; Akt Emërim i D.Sh. i datës 25.02.2020; Kontratë e Marrëdhënies së Punës e S.H. i datës 07.08.2023; Vendim për emërimin e Z.S. i datës 01.06.2011; Akt Emërim i S.F. i datës 03.02.2016; Akt Emërim i S.H. i datës 02.11.2012; Akt Emërim i F.O. i datës 27.10.2023; Akt Emërim i P.S. i datës 06.07.2015; Ndryshim dhe plotësim i akt emërimit i H.M. i datës 23.08.2018; Akt Emërim i D.A. i datës 04.11.2021; Akt Emërim i A.G. i datës 25.04.2012; Akt Emërim i N.L. i datës 06.07.2017; Akt Emërim i L.U. i datës 02.07.2019; Akt Emërim i H.R. i datës 31.05.2017; Akt Emërim i Z.S. i datës 25.04.2012; Akt Emërim i N.Z. i datës 25.04.2012; Ndryshim dhe plotësim i akt emërimit i A.B. i datës 25.04.2012; Akt Emërim i H.H. i datës 17.05.2017; Plotësim ndryshim i akt emërimit i I.A. i datës 05.06.2023; Akt Emërim i R.M. i datës 07.02.2012; Marrëveshje mes Drejtorisë për Arsim dhe Drejtorisë për Administratë dhe personal në Skenderaj për H.K. i datës 17.06.2013; Akt Emërim i L.F. i datës 01.10.2012; Akt Emërim i Xh.M. i datës 25.04.2012; Vendim për emërim i N.G. i datës 30.05.2011; Akt Emërim i S.D. i datës 01.04.2022; Akt Emërim i A.D. i datës 31.08.2018; Vendim për emërim i B.S. i datës 31.05.2011; Akt Emërim i F.L.M. i datës 06.07.2021; Akt Emërim i Sh.H. i datës 30.04.2012; Akt Emërim i N.L. i datës 06.07.2017; Akt Emërim i V.S. i datës 25.03.2021; Akt Emërim i E.S. i datës 30.04.2012; Akt Emërim i R.Sh. i datës 30.04.2012; Vendim për transfer i F.S. i datës 04.11.2024; Akt Emërim i V.H. i datës 08.09.2014; Akt Emërim i A.A. i datës 02.10.2020; Akt Emërim i M.L. i datës 13.06.2023; Akt Emërim i S.A. i datës 03.05.2012; Akt Emërim i A.A. i datës 27.12.2024; Akt Emërim i V.A. i datës 10.10.2023; Akt Emërim i A.I. i datës 17.04.2012; Akt Emërim i V.J. i datës 18.03.2013; Akt Emërim i A.M. i datës 28.05.2015; Akt Emërim i Z.R. i datës 07.05.2012; Akt Emërim i Z.E. i datës 07.05.2012; Akt Emërim i B.H. i datës 10.05.2023; Akt Emërim i B.K. i datës 03.08.2020; Akt Emërim i Sh.F.H. i datës 08.02.2019; Akt Emërim i R.V. i datës 02.05.2018; Akt Emërim i Y.V. i datës 18.05.2021; Akt Emërim i M.V. i datës 21.05.2024; Akt Emërim i D.B. i datës 21.02.2020; Akt Emërim i N.L. i datës 07.05.2012; Akt Emërim i B.I. i datës 23.04.2012; Vendim për transfer i A.G. i datës 13.05.2020; Akt Emërim i A.M. i datës 04.11.2024; Akt Emërim i R.H. i datës 26.09.2023; Akt Emërim i G.P. i datës 10.05.2023; Akt Emërim i B.S. i datës 19.06.2020; Akt Emërim i Xh.D. i datës 07.05.2012; Akt Emërim i V.H. i datës 27.05.2014; Akt Emërim i H.G. i datës 09.08.2018; Akt Emërim i H.G. i datës 25.04.2012; Ndryshim dhe plotësim i akt emërimit i Sh.Q. i datës 15.08.2018; Akt Emërim i I.P. i datës 10.11.2022; Akt Emërim i F.B. i datës 27.03.2014; Akt Emërim i Rr.I. i datës 02.10.2013; Akt Emërim i R.Y. i datës 03.05.2012; Akt Emërim i D.K. i datës 07.05.2012; Akt Emërim i

Z.P. i datës 07.05.2012; Akt Emërim i F.F. i datës 24.11.2016; Akt Emërim i Q.D.U. i datës 09.02.2023; Akt Emërim i I.S. i datës 31.07.2023; Akt Emërim i F.R. i datës 01.05.2011; Vendim për shtyrje të afatit i KPMSHCK me numër protokolli 2673/2025 i datës 22.04.2025;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit F.G, E.L, S.H, Z.S, H.M, A.G, H.H, Xh.M, F.R, F.F dhe Rr.I, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se ankuesi F.Gi sipas Akt Emërimit të datës 25.04.2012 është i punësuar në pozitën Vozitës në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit, ankuesja E.L sipas Kontratës së Marrëdhënies së Punës të datës 06.02.2023 është e punësuar në pozitën Zyrtar i Funksioneve Mbështetëse në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Skenderajit, ankuesi S.H sipas Kontratës së Marrëdhënies së Punës të datës 07.08.2023 është i punësuar në pozitën Postshpërndarës në Komunën e Skenderajit, ankuesja Z.S sipas vendimit për emërim të datës 01.06.2011 është e punësuar në pozitën Bibliotekiste në runik Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Skenderajit, ankuesi A.G sipas Akt Emërimit të datës 25.04.2012 është i punësuar në pozitën Vozitës në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit, ankuesi Xh.M sipas Akt Emërimit të datës 25.04.2012 është i punësuar në pozitën Kurir në zgjc në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit, ankuesi F.F sipas Akt Emërimit të datës 24.11.2016 është i punësuar në pozitën Vozitës në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit dhe ankuesi Rr.I sipas Akt Emërimit të datës 02.10.2013 është i punësuar në pozitën Vozitës në Drejtorinë e Shërbimeve Publike në Komunën e Skenderajit.

Sipas përgjigjes nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Skenderajit të datës 04.02.2025, Ankuesi H.M i pensionuar me datë 01.03.2024, ankuesi F.R i pensionuar me datë 31.01.2024 dhe ankuesi H.H i pensionuar me datë 05.07.2023. Kolegji i Këshillit ka konstatuar se të njëjtit nuk e kanë statusin e shërbyesve civil pasi që të njëjti janë pensionuar.

Kolegji i Këshillit i'u referua fillimisht dispozitave të Ligjit N.08/L-197 për Zyrtarët Publik përkatësisht me nenin 5 paragrafin 3 dhe 5 ku është përcaktuar se; *1. Kategoritë e zyrtarëve/publik janë: 1.1. Nëpunësja/i i shërbimit civil; 1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik; 1.3. Krijuesja/i dhe performuesja/i e/i artit dhe kulturës; 1.4. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës; dhe 1.5. Zyrtarja/i i kabinetit...* **3. Nëpunësja/i i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësja/i i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës.** **5. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës është zyrtarja/i publik që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, të vozitjes dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike,** rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në pozitën e ankuesve Vozitës, Zyrtar i Funksioneve Mbështetëse, Postshpërndarës

dhe Kurir. Kolegji i Këshillit konstatoi se në rastin konkret këto pozita janë kategorizuar si nëpunës teknik dhe mbështetës. Ndërsa pozita bibliotekist është kategorizuar si nëpunës i shërbimit publik.

Në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit, sepse Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil.

Andaj duke pas parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.439/2025 të datës 10.03.2025. Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që lënda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit të Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik të Komunës së Skenderajit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 77 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *1. Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të ligjit, marrëdhënia e punës për nëpunësen/in e shërbimit publik rregullohet sipas dispozitave të Ligjit përkatës të Punës*, si dhe nenin 88 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *1. Nëpunësja/i i shërbimit publik mund të ankohet kur pretendon se i janë shkelur të drejtat në marrëdhënien e punës. Të drejtën e ankesës e kanë dhe kandidatët në procedurë rekrutuese në shërbimin publik. 2. Ankesa sipas paragrafit 1. të këtij neni paraqitet sipas afateve të përcaktuara në ligjin për procedurën administrative nga dita e pranimin të vendimit përfundimtar.* Si dhe Ligjin Nr. 03/L-212 i Punës përkatësisht nenin 78 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *1. I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimin të kërkesës.* Ndërsa me nenin 79 paragrafi 1 përcakton se: *Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente .*

Andaj pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e ankuesve, atëherë ekziston baza ligjore që të detyrohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së

Skenderajit, të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës me numër 02-120/01-0003884/25 të datës 23.01.2025 të parashtruar nga ankuesit, **sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankuesi K.J sipas Kontratës së Marrëdhënies së Punës të datës 06.02.2023 është i punësuar në pozitën Zyrtar për Edukim dhe Informim të Tatimpaguesve në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Skenderajit, ankuesi S.F sipas vendimit për emërim të datës 31.05.2011 është i punësuar në pozitën Zyrtar në zake Drejtoria e Shërbimeve Publike në Komunën e Skenderajit, ankuesja F.L-M sipas Akt Emërimit të datës 11.06.2019 është e punësuar në pozitën Zyrtare për Gjendje Civile në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit, ankuesi Z.D sipas Akt Emërimit të datës 03.04.2012 është i punësuar në pozitën Zyrtar i Mbrojtjes Civile dhe Emergjente në Drejtorinë për Shërbime Publike në Komunën e Skenderajit, ankuesi G.B sipas Akt Emërimit të datës 04.03.2021 është i punësuar në pozitën Zyrtar i Lart i Prokurimit në Departamentin zyra Prokurimit në Komunën e Skenderajit, ankuesi N.G sipas Akt Emërimit të datës 03.07.2018 është i punësuar në pozitën Udhëheqës i sektorit për shërbime publike në Drejtorinë për Shërbime Publike në Komunën e Skenderajit, ankuesja Sh.R sipas Akt Emërimit të datës 03.05.2012 është e punësuar në pozitën Zyrtare administrative e tatimit në pronë në Drejtorinë e Ekonomisë Financave dhe Zhvillimit në Komunën e Skenderajit, ankuesi S.D sipas vendimit të datës 24.12.2024 është i punësuar në pozitën Zyrtar për Arkiv në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit, ankuesja N.V sipas Akt Emërimit të datës 11.06.2019 është e punësuar në pozitën Zyrtare për Arkiv 2 në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit, ankuesja V.U sipas Akt Emërimit të datës 25.04.2012 është e punësuar në pozitën Zyrtare Administrative në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit, ankuesi H.N sipas Akt Emërimit të datës 28.12.2016 është i punësuar në pozitën Anketues shpërndarës i faturave në Drejtorinë e Ekonomisë Financave dhe Zhvillimit në Komunën e Skenderajit, ankuesi J.M sipas Akt Emërimit të datës 18.05.2021 është i punësuar në pozitën Udhëheqës i sektorit për gjendje civile në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit, ankuesi L.K sipas Akt Emërimit të datës 11.03.2022 është i punësuar në pozitën Zyrtar i të hyrave financiare në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Skenderajit, ankuesja F.XH sipas Akt Emërimit të datës 19.10.2012 është e punësuar në pozitën Arkiviste në Drejtorinë e Ekonomisë Financave dhe Zhvillimit në Komunën e Skenderajit, ankuesi Sh.R sipas ndryshim dhe plotësimit të akt emërimit të datës 24.01.2020 është i punësuar në pozitën Zyrtar për Arkiv 3 në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit, ankuesi B.V sipas Akt Emërimit të datës 01.11.2013 është i punësuar në pozitën Zyrtar për fletëkërkesa të automjeteve në Drejtorinë e Ekonomisë Financave dhe Zhvillimit në Komunën e Skenderajit, ankuesja F.A sipas Akt Emërimit të datës 03.05.2012 është e punësuar në pozitën Zyrtar për transakcion të pasurisë barazim të bllokave dhe dëftesave në Drejtorinë e Ekonomisë Financave dhe Zhvillimit në Komunën e Skenderajit, ankuesi H.K sipas Akt Emërimit të datës 27.04.2012 është i punësuar në pozitën Zyrtar profesional i Prokurimit në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit, ankuesja K.H-S sipas Akt Emërimit të datës 25.02.2020 është e punësuar në pozitën Zyrtare e Prokurimit 2 në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit, ankuesja H.Z sipas Akt Emërimit të datës 27.04.2012 është e punësuar në pozitën Zyrtare profesionale e Prokurimit në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit, ankuesi N.D sipas Akt Emërimit të datës 25.04.2012 është i punësuar në pozitën Zyrtar profesional për regjistrim të biznesit dhe leje pune në Drejtorinë e Ekonomisë Financave dhe Zhvillimit në Komunën e Skenderajit, ankuesja A.R sipas Akt Emërimit të datës 23.03.2021 është e punësuar në pozitën Zyrtare e lartë për turizëm kulturor në

Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik Ndërmarrësi Inovacion dhe Turizëm në Komunën e Skenderajit, ankuesi B.B sipas Akt Emërimit të datës 01.10.2020 është i punësuar në pozitën Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik Ndërmarrësi Inovacion dhe Turizëm në Komunën e Skenderajit, ankuesi B.Z sipas Akt Emërimit të datës 11.06.2020 është i punësuar në pozitën Zyrtar për të drejta e njeriut në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit, ankuesja D.SH sipas Akt Emërimit të datës 25.02.2020 është e punësuar në pozitën Zyrtare Ligjore 2 në Drejtorinë për Ekonomi Financa dhe Zhvillim në Komunën e Skenderajit, ankuesi S.F sipas Akt Emërimit të datës 03.02.2016 është i punësuar në pozitën Shef i sektorit të Bujqësisë në Drejtorinë për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Skenderajit, ankuesi S.H sipas Akt Emërimit të datës 02.11.2012 është i punësuar në pozitën Shef i sektorit për Mbrojtje dhe shpëtim në Drejtorinë e Shërbimeve Publike në Komunën e Skenderajit, ankuesi F.O sipas Akt Emërimit të datës 27.10.2023 është i punësuar në pozitën Zyrtar për Emergjencja 1 në Drejtorinë e Shërbimeve Publike në Komunën e Skenderajit, ankuesi P.S sipas Akt Emërimit të datës 06.07.2015 është i punësuar në pozitën Zyrtar i gjendjes civile në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit, ankuesi D.A sipas Akt Emërimit të datës 04.11.2021 është i punësuar në pozitën Zyrtar për shtetësi në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit, ankuesi N.L sipas Akt Emërimit të datës 06.07.2017 është i punësuar në pozitën Zyrtar administrativ në Drejtorinë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë në Komunën e Skenderajit, ankuesi L.U sipas Akt Emërimit të datës 02.07.2019 është i punësuar në pozitën Asistent administrativ në Drejtorinë zyra komunale për komunitete në Komunën e Skenderajit, ankuesi H.R sipas Akt Emërimit të datës 31.05.2017 është i punësuar në pozitën Udhëheqës i sektorit të tatimit në pronë në Drejtorinë për Ekonomi Financa dhe Zhvillim në Komunën e Skenderajit, ankuesja Z.S sipas Akt Emërimit të datës 25.04.2012 është e punësuar në pozitën Zyrtar i gjendjes civile në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit, ankuesi N.Z sipas Akt Emërimit të datës 25.04.2012 është i punësuar në pozitën Zyrtar i gjendjes civile në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit, ankuesi A.B sipas ndryshim dhe plotësimit të akt emërimit të datës 25.04.2012 është i punësuar në pozitën Zyrtar për protokoll në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit, ankuesi H.H sipas Akt Emërimit të datës 17.05.2017 është i punësuar në pozitën Zyrtar i pagesave dhe çështjeve juridike në Drejtorinë për Financa Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Skenderajit, ankuesi I.A sipas plotësim ndryshimit të Akt Emërimit të datës 05.06.2023 është i punësuar në pozitën Zyrtar Certifikues në Drejtorinë për Ekonomi dhe Financa në Komunën e Skenderajit, ankuesi R.M sipas Akt Emërimit të datës 07.02.2012 është i punësuar në pozitën Zyrtar i gjendjes civile në zyren e gjendjes civile në Runik në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit, ankuesi H.K sipas marrëveshjes të datës 17.06.2013 mes drejtorisë për arsim dhe drejtorisë për administratë dhe personel është i punësuar në pozitën Ofiqar në Komunën e Skenderajit, ankuesi L.F sipas Akt Emërimit të datës 01.10.2012 është i punësuar në pozitën Zyrtar për shpenzime në Komunën e Skenderajit, ankuesi N.G sipas vendimit për emërim të datës 27.05.2011 është i punësuar në pozitën Zyrtar profesional për bujqësi në Drejtorinë për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Skenderajit, ankuesja S.D sipas Akt Emërimit të datës 01.04.2022 është e punësuar në pozitën Arkëtar Zyrtar në Drejtorinë për Financa Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Skenderajit, ankuesi A.D sipas Akt Emërimit të datës 31.08.2018 është i punësuar në pozitën Zyrtar i gjendjes civile në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit, ankuesja B.S sipas Akt Emërimit të datës 31.05.2011 është e punësuar në pozitën Zyrtare administrative e protokollit në Drejtorinë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë në Komunën e Skenderajit, ankuesja F.L-M sipas Akt Emërimit të datës 06.07.2021 është e punësuar në pozitën Zyrtare Ligjore 2 në Drejtorinë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë në Komunën e Skenderajit,

ankuesja Sh.H sipas Akt Emërimit të datës 30.04.2012 është e punësuar në pozitën Zyrtare për ndërrime në Drejtorinë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë në Komunën e Skenderajit, ankuesi N.L sipas Akt Emërimit të datës 06.07.2017 është i punësuar në pozitën Zyrtar administrativ në Drejtorinë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë në Komunën e Skenderajit, ankuesi V.S sipas Akt Emërimit të datës 25.03.2021 është i punësuar në pozitën Zyrtar për Buxhet dhe Financa në Drejtorinë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë në Komunën e Skenderajit, ankuesi E.S sipas Akt Emërimit të datës 30.04.2012 është i punësuar në pozitën Zyrtar profesional për regjistrim të paluajtshmërive në Drejtorinë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë në Komunën e Skenderajit, ankuesi R.SH sipas Akt Emërimit të datës 30.04.2012 është i punësuar në pozitën Gjeometër për ndërrime në teren në Drejtorinë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë në Komunën e Skenderajit, ankuesi F.S sipas vendimit të datës 04.11.2024 është i punësuar në pozitën Zyrtar për kadastër në Drejtorinë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë në Komunën e Skenderajit, ankuesi V.H sipas Akt Emërimit të datës 01.05.2011 është i punësuar në pozitën Zyrtar i projekteve kapitale në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit në Komunën e Skenderajit, ankuesi A.A sipas Akt Emërimit të datës 01.10.2020 është i punësuar në pozitën Zyrtar i Pasurisë në Drejtorinë për Ekonomi Financa dhe Zhvillim në Komunën e Skenderajit, ankuesi M.L sipas Akt Emërimit të datës 13.06.2023 është i punësuar në pozitën Auditor i Brendshëm në Departamentin Njësia e Auditimit në Komunën e Skenderajit, ankuesja S.A sipas Akt Emërimit të datës 01.05.2011 është i punësuar në pozitën Shefe e sektorit të urbanizmit në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit në Komunën e Skenderajit, ankuesja A.A sipas Akt Emërimit të datës 27.12.2024 është e punësuar në pozitën Zyrtar për Arkiv 2 në Departamentin për Urbanizëm në Komunën e Skenderajit, ankuesja V.A sipas Akt Emërimit të datës 10.10.2023 është e punësuar në pozitën Zyrtar i lart ligjor në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit në Komunën e Skenderajit, ankuesja A.I sipas Akt Emërimit të datës 17.04.2012 është e punësuar në pozitën Zyrtar i Ambientit në Drejtorinë për Urbanizëm Ndërtim dhe Mbrojtje të Ambientit në Komunën e Skenderajit, ankuesja V.J sipas Akt Emërimit të datës 18.03.2013 është e punësuar në pozitën Zyrtare për planifikim urban dhe hapsinor në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit në Komunën e Skenderajit, ankuesi A.M sipas Akt Emërimit të datës 28.05.2015 është i punësuar në pozitën Zyrtar për Ndërtimtari në Drejtorinë për Urbanizëm në Komunën e Skenderajit, ankuesi Z.R sipas Akt Emërimit të datës 07.05.2012 është i punësuar në pozitën Inspektor i Ndërtimit në Drejtorinë e shërbimeve Publike në Komunën e Skenderajit, ankuesja Z.E sipas Akt Emërimit të datës 07.05.2012 është e punësuar në pozitën Zyrtare për Mirëqenie Sociale në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Skenderajit, ankuesi B.H sipas Akt Emërimit të datës 10.05.2023 është i punësuar në pozitën Zyrtar administrativ në Drejtorinë për Shërbim Social në Komunën e Skenderajit, ankuesi B.K sipas Akt Emërimit të datës 03.08.2020 është i punësuar në pozitën Zyrtar për Mirëqenie Sociale në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Skenderajit, ankuesja Sh.F-H sipas Akt Emërimit të datës 08.02.2014 është e punësuar në pozitën Zyrtare e shërbimeve sociale dhe familjare në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Skenderajit, ankuesi R.V sipas Akt Emërimit të datës 02.05.2018 është i punësuar në pozitën Zyrtar për Mirëqenie Sociale në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Skenderajit, ankuesi Y.V sipas Akt Emërimit të datës 18.05.2021 është i punësuar në pozitën Udhëheqës i sektorit për shërbime sociale në DSHMS në Komunën e Skenderajit, ankuesja M.V sipas Akt Emërimit të datës 21.05.2024 është e punësuar në pozitën Zyrtare për Shërbime Sociale 2 në Departamentin Qendra për Punë Sociale në Komunën e Skenderajit, ankuesja D.B sipas Akt Emërimit të datës 21.02.2020 është e punësuar në pozitën Zyrtare për Shërbime Sociale 1 në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Skenderajit,

ankuesi N.L sipas Akt Emërimit të datës 07.05.2012 është i punësuar në pozitën Zyrtar i asistencës sociale në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Skenderajit, ankuesi B.I sipas Akt Emërimit të datës 23.04.2012 është i punësuar në pozitën Zyrtar profesional i sportit në Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Skenderajit, ankuesi A.G sipas vendimit të datës 13.05.2020 është i punësuar në pozitën Udhëheqës i sektorit të bibliotekës në Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Skenderajit, ankuesja A.M sipas Akt Emërimit të datës 04.11.2024 është e punësuar në pozitën Inspektor i Tregut në Drejtorinë për Inspektorat në Komunën e Skenderajit, ankuesi R.H sipas Akt Emërimit të datës 26.09.2023 është i punësuar në pozitën Inspektor i Tregut në Drejtorinë për Inspektorat në Komunën e Skenderajit, ankuesja G.P sipas Akt Emërimit të datës 10.05.2023 është e punësuar në pozitën Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit në Drejtorinë për Inspektorat në Komunën e Skenderajit, ankuesi B.S sipas Akt Emërimit të datës 19.06.2020 është i punësuar në pozitën Inspektor i Komunikacionit në Drejtorinë për Inspektorat në Komunën e Skenderajit, ankuesi Xh.D sipas Akt Emërimit të datës 07.05.2012 është i punësuar në pozitën Inspektor i Tregut në Drejtorinë e shërbimeve Publike në Komunën e Skenderajit, ankuesi V.H sipas Akt Emërimit të datës 27.05.2014 është i punësuar në pozitën Shërbimtar i sektorit të Inspektoratit në Drejtorinë e shërbimeve Publike në Komunën e Skenderajit, ankuesi H.G sipas Akt Emërimit të datës 09.08.2018 është i punësuar në pozitën Drejtor i Qendrës për Punë Sociale në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Skenderajit, ankuesi H.G sipas Akt Emërimit të datës 25.04.2012 është i punësuar në pozitën Shërbimtar i zyrës pritëse dhe arkivit në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit, ankuesja Sh.Q sipas ndryshim plotësimit të Akt Emërimit të datës 15.08.2018 është e punësuar në pozitën Zyrtare e Gjendjes Civile në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit, ankuesi I.P sipas Akt Emërimit të datës 10.11.2022 është i punësuar në pozitën Zyrtar i lart për përkthime në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Skenderajit, ankuesi F.B sipas Akt Emërimit të datës 27.03.2014 është i punësuar në pozitën Koordinator për Kthim në Drejtorinë zyra komunale për komunitete në bajë në Komunën e Skenderajit, ankuesi R.Y sipas Akt Emërimit të datës 03.05.2012 është i punësuar në pozitën Zyrtar profesional për arsim të mesëm në Drejtorinë për Arsim në Komunën e Skenderajit, ankuesja D.K sipas Akt Emërimit të datës 07.05.2012 është e punësuar në pozitën Zyrtar i asistencës sociale në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Skenderajit, ankuesi Z.P sipas Akt Emërimit të datës 07.05.2012 është i punësuar në pozitën Zyrtar i asistencës sociale në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Skenderajit, ankuesja Q.D-U sipas Akt Emërimit të datës 09.02.2023 është e punësuar në pozitën Zyrtar për Barazi Gjinore në Drejtorinë e Administratës në Komunën e Skenderajit dhe ankuesi I.S sipas Akt Emërimit të datës 31.07.2013 është i punësuar në pozitën Inspektor i parandalimit nga zjarri në Njësinë profesionale zjarrfikëse dhe shpëtimit në Komunën e Skenderajit.

Ankuesit përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar me datë 23.01.2025 me numër 02-120/01-0003884/25 kanë parashtruar kërkesë tek Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Skenderajit lidhur me shujtat për ditët e pranisë në punë për vitet 2021, 2022, 2023 dhe 2024 nga (3.5) Euro për një ditë pune duke u bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, shtesat në pagë për secilin nëpunës të Komunës prej 0.5% për vitet e përvojës në punë nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, lidhur me nxjerrjen e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese KO79/23 i datës 23.01.2024, shtesat e SHCK në pagë nga 31.20 euro për muaj për secilin nëpunës ashtu siç i kanë realizuar para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Skenderajit me datë 05.02.2025 me numër 02-120/02-0005627/25 i ka refuzuar kërkesat për shtesat

përkatëse. Mirëpo në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit përgjigjja nuk i përmban elementet e aktit administrativ.

Kolegji i Këshillit, lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative, konstaton se meqë palët ankuese më datë 23.01.2025 me numër 02-120/01-0003884/25 kanë parashtruar kërkesë për kompensim material tek Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Skenderajit, atëherë lidhur me obligimin e organit publik që të shqyrtoj në mënyrë të drejtë kërkesën dhe të nxjerr aktin administrativ, ju referuar Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative respektivisht nenit 11 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2, i cili përcakton se: *“3. Organi u siguron personave të interesuar dhe palëve informacion të saktë, të qartë dhe të kuptueshëm rreth: 3.2. kërkesave thelbësore ligjore si dhe procedurave e formaliteteve të parashikuara për nxjerrjen e një akti administrativ apo realizimin e një akti real të kërkuar, përfshirë këtu edhe dokumentet dhe deklaratat që duhen parashtruar”*, nenit 27 paragrafi 1, i cili përcakton se: *“1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, zyrtari përgjegjës zhvillon procedurën administrative, vendos për çështjen, e nënshkruan vendimin si dhe siguron njoftimin e palës”*, nenit 97 paragrafi 1, i cili përcakton se: *“1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative”*, në këtë rast, në kuptim të nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj”*, organi të cilit i është drejtuar kërkesa është dashur të vendos brenda afatit prej 45 ditësh apo të aplikohet neni 99 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, mirëpo meqë kërkesa e palës ankuese nuk është shqyrtuar, atëherë është aplikuar heshtja administrative. Sipas dispozitave ligjore në fuqi në rast se organi publik hesht ndaj kërkesës së palës, atëherë palës i lind e drejta që të parashtroj ankesë tek organi i shkallës më të lartë për heshtje administrative duke u bazuar në dispozitat e nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ”*, si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse organi i punësimit ka heshtur ndaj kërkesës së ankuesve, ankesa e tyre e datës 10.03.2025 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e pranueshme në kuptim të nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar kuadrit ligjor të përmendur si më lartë dhe lidhur me obligimin e organit përkatës për të vendosur lidhur me kërkesën e palëve, obligon organin përkatës të punësimit gjegjësisht Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Skenderajit, që të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës të datës 23.01.2025 të parashtruar nga ankuesit, dhe në atë mënyrë që gjatë shqyrtimit të kërkesës të shqyrtohet të gjitha pretendimet e palëve ankuese dhe të vendoset për të gjitha pretendimet në fjalë në kuptim të nenit 48 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Po ashtu Kolegji i Këshillit, sjell në vëmendje se gjatë shqyrtimit të kërkesës së datë 23.01.2025 së palëve

ankuese, duhet të shqyrtohet fakti nëse kërkesa plotëson kushtet ligjore lidhur me parashkrimin në kuptim të nenit 87 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.439/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve avokatit Esat Sylaj;
- Komunës së Skenderajt (Komisionit të Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore); si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.